

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | 81 vite burg në total për 4 ish-krerët e UÇK-së/ Çfarë vendosi Haga për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe S elimin                                                                                                                                       |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/politika/81-vite-burg-ne-total-per-4-ish-kreret-e-uk-se-fare-vendosi-haga-per-th-i586434">https://www.gazetatema.net/politika/81-vite-burg-ne-total-per-4-ish-kreret-e-uk-se-fare-vendosi-haga-per-th-i586434</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 16 shtator 2026, 10:11:13 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 10:12:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 3fd6fae52a4763d6407650482838608ad54d32d45ec032644b2d9ece2e14e562 |
| TEKSTI     | c238382fa8465cfe01d1c05778dc8e7fb2aca732b55175bf98cf97af5f5f8232 |
| PAMJA      | b7546efe7cfe27ce789ac7dcba9859eb73a196dd205057932f9fff311139b37e |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | cf1e8af1877de066ea8935897501fc8c1c6a977e3063a9f1d445134ab743c1f7                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf1e8af1877de066ea8935897501fc8c1c6a977e3063a9f1d445134ab743c1f7>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Denimi i ish-krevere te UÇK-se ne Hage, trishtim dhe lot ne sheshin "Skenderbeu" ne Prishtine Denimi nga Haga/ Vellai i Hashim Thaçit: Presim Apelin, jemi te bindur ne fundit

## 81 vite burg në total për 4 ish-krerët e UÇK-së/ Çfarë vendosi Haga për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin



16 Shtator 2026, 12:12 Politika TEMA



## Jakup Krasniqi

### 25 vite burg

## Rexhep Selimi

### 13 vite burg

Katër ish-krerët e UÇK-së u dënuan sot me 81 vite burg në total nga Dhomat e Specializuara në Hagë, në një prej proceseve më të gjata dhe më të ndjekura që lidhen me luftën e Kosovës. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi morën nga 25 vite burg, Kadri Veseli 18 vite, ndërsa Rexhep Selimi 13 vite. Të katër u shpallën fajtorë për krime lufte, ndërsa u shpallën të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë erdhi pas një procesi që nisi në prill të vitit 2023 dhe përfshiu 134 dëshmitarë, mijëra prova dhe disa vite shqyrtim gjyqësor. Katër të pandehurit, të cilët janë mbajtur në paraburgim në Hagë që prej nëntorit 2020, i kanë mohuar akuzat gjatë gjithë procesit.

Në leximin e vendimit, trupi gjyqësor bëri një ndarje të qartë mes akuzave për krime lufte dhe atyre për krime kundër njerëzimit. Sipas gjykatës, Prokuroria arriti të provojë përgjegjësinë penale për ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, por nuk provoi ekzistencën e një sulmi të përhapur kundër popullatës civile në nivelin e kërkuar për krime kundër njerëzimit.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vite burg. Trupi gjyqësor e shpalli fajtor për arrestim dhe ndalim të paligjshëm, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme. Gjykata tha se Thaçi kishte dhënë kontribut të rëndësishëm në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe se në disa raste kishte marrë pjesë drejtpërdrejt ose kishte inkurajuar veprimet kriminale. Reuters konfirmoi dënimin me 25 vite dhe faktin se ai u shpall fajtor për krime lufte.

Jakup Krasniqi mori po ashtu 25 vite burg. Sipas aktgjykimit të lexuar në sallë, ai u shpall fajtor për disa akuza për krime lufte që lidhen me ndalimin e paligjshëm, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen, ndërsa u shpall i pafajshëm për krime kundër njerëzimit.

Kadri Veseli u dënua me 18 vite burg. Edhe në rastin e tij, trupi gjyqësor konstatoi përgjegjësi për krime lufte, por jo për akuzat për krime kundër njerëzimit.

Rexhep Selimi mori dënimin më të ulët nga katër të pandehurit, 13 vite burg. Gjykata arriti në përfundimin se Prokuroria kishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë e tij për një pjesë të akuzave për krime lufte, ndërsa e shpalli të pafajshëm për krime kundër njerëzimit.

Një nga pjesët më të rënda të aktgjykimit lidhej me viktimat. Trupi gjyqësor konstatoi se ndërmjet prillit 1998 dhe qershorit 1999, pjesëtarë të UÇK-së kryen veprime që çuan në vrasjen e 96 personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime. Gjykata foli gjithashtu për ndalimin e qindra personave, keqtrajtime, tortura dhe kushte çnjerëzore në disa qendra ndalimi në Kosovë dhe Shqipëri. Në rastin e Thaçit, Reuters raporton se gjykata e lidhi atë me vrasjen e 96 personave, ndalimin e paligjshëm të 385 personave dhe torturimin e 303 të tjerëve.

Procesi kishte edhe një dimension të fortë politik dhe simbolik në Kosovë. Para shpalljes së vendimit, mijëra qytetarë morën pjesë në aktivitete në mbështetje të katër ish-krerëve të UÇK-së, ndërsa mbështetës të tyre u mbledhën edhe jashtë gjykatës në Hagë. Për shumë shqiptarë të Kosovës, katër të akuzuarit mbeten figura të luftës çlirimtare, ndërsa vetë gjykata ka qenë objekt kritikash dhe mosbesimi.

Nga ana tjetër, kryesuesi i trupit gjyqësor, Charles Smith, e nisi seancën duke theksuar se procesi nuk kishte për objekt legjitimitetin e luftës së UÇK-së apo pavarësinë e Kosovës, por përgjegjësinë penale individuale të katër të pandehurve.

Megjithatë, procesi nuk përfundon me aktgjykimin e sotëm. Vendimi i shpallur nga Dhomat e Specializuara është i shkallës së parë dhe si mbrojtja, ashtu edhe Prokuroria kanë të drejtë ta ankimojnë. Kjo do të thotë se çështja mund të kalojë në Apel, ku vendimi mund të lihet në fuqi, të ndryshohet ose të rrëzohet pjesërisht apo tërësisht, sipas argumenteve që do të paraqesin palët.

#### Tema

#### Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

[Balla pas vendimit të Gjykatës Speciale: Kjo nuk është drejtësi, historia e UÇK-së nuk zhbëhet](#)

11:57 Politika / 1 koment

Rama në Korçë për reformën territoriale, Maliqi në qendër të diskutimit

11:22 Politika

## [“Paketa e Maleve” në Kushtetuese, ankesa kalon për shqyrtim në seancë plenare](#)

09:31 Politika / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.